

**“AMOSFARMA”SHPK**

**SELIA: Njesia Administrative Shenkoll, fshati Shenkoll, V11, fq 136 me Nr. pasurie 83/207.**

**NR Prot: 01 date 27/04/2023**

**Vendim**

Nr : 02, date 27/04/2023

Sot me date 27/04/2023 u zhvillua Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise tregtare “AMOSFARMA”SHPK themeluar me date 26/04/2023 me seli ne Shenkoll dhe,

Vendosen:

- 1- Emerimin e Z.Edi Markaj si administrator te Shoqerise “AMOSFARMA” SHPK.
- 2- Autorizojme Z.Edi Markaj per te kryer te gjitha veprimet financiare si arketime, depozitime, transferta per llogari te shoqerise “AMOSFARMA”.
- 3- Autorizojme Z. Edi Markaj te perfaqesoje shoqerine “AMOSFARMA” ne marrdhenjet formale dhe joformale me pale te treta si edhe ne ceshtje ligjore dhe institucionale.
- 4- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**Ortaket themelues**

**“AMOSFARMA” SH.P.K**

**Brunilda Hasanbelli**



**Edi Markaj**



**Valbona Kamberi**



**AKT - THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“AMOSFARMA” SH.P.K**

**FORMIMI**

Bazuar në kërkesat e ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 " Për shoqëritë tregtare" sot me date 05/04/2023 formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “AMOSFARMA” SH.P.K e ortakeve themelues:

- 1- Brunilda Hasanbelli, shtetase Shqiptare, e bija e Agim, e lindur ne Shkoder me 13.08.1993 dhe banuese ne Tale 2, Shenkoll, Lezhe, gjendja civile “e martuar”, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi me Nr J35813085A.
- 2- Edi Markaj, Shtetas Shqiptar, i biri i Fran, i lindur ne Lac me 19.08.1980 dhe banues ne Lezhe, gjendja civile, “I martuar”, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi me Nr I00819184W
- 3- Valbona Kamberi, shtetase Shqiptare, e bija e Sulejman, e lindur ne Kurbnesh, Mirdite me 26.05.1967 dhe banuese ne Lezhe, gjendja civile “e divorcuar”, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi me Nr G75526083S.

Sot me datë 05.04.2023 kemi vendosur të themelojme në Shqipëri, në Shenkoll, Lezhe, nje shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “AMOSFARMA” SH.P.K

**SELIA**

Selia e shoqërise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “AMOSFARMA” SH.P.K ndodhet ne adresën, Njesia Administrative Shenkoll, fshati Shenkoll, ndërtesë 2 kateshe, kati i parë e cila eshte ne pronesi te Z. Angjelin Mark Ndoka, V11, fq 136 me Nr. pasurie 83/207.

Shoqëria ka të drejtë të hapë zyra, përfaqësi dhe filiale edhe në rrethet e tjera të vendit si dhe jashtë shtetit.

### **FORMA JURIDIKE**

Forma juridike e shoqërisë është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është e pakufizuar në kohë.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë “**AMOSFARMA**” **SH.P.K** është :

1. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm farmaceutike
2. Tregtim me shumice dhe pakice te produkteve nutricional
3. Tregetimi me shumice dhe pakice te produkteve kozmetike dhe estetike

### **KAPITALI I SHOQERISË**

Kapitali i shoqërisë “**AMOSFARMA**” **SH.P.K**, është 1000 (njëmije) lekë, i ndare ne 3 kuota me vleren ne perqindje dhe ne leke:

- |                                    |  |
|------------------------------------|--|
| 1- <b>Znj. Brunilda Hasanbelli</b> | <b>51 %</b> të kapitalit ose <b>1</b> kuote ne vlere <b>510</b> leke |
| 2- <b>Z.Edi Markaj</b>             | <b>39 %</b> te kapitalit ose <b>1</b> kuote ne vlere <b>390</b> leke |
| 3- <b>Znj. Valbona Kamberi</b>     | <b>10 %</b> te kapitalit ose <b>1</b> kuote ne vlere <b>100</b> leke |

### **ORGANET DREJTUESE**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në asamble dhe të bëjnë prezent opinionin e tyre. Numri i votave të cdo ortaku është në raport me pjesën e tij të kapitalit në kapitalin themëlor të shoqërisë.

Shoqëria “**AMOSFARMA**” **SH.P.K** , do të drejtohet nga administratori **Z. Edi Markaj**, i cili emërohet nga asambleja e ortakeve themëlues te kësaj shoqerie me afat 5-vjecar me të drejtë përsëritje. Në marrëdhënie më të tretët shoqëria përfaqësohet nga administratori.

Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili i bashkëngjit emërimin tregtar të shoqërisë emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

Akti i Themelimit nënshkruhet rregullisht nga Ortaket themelues.


Ky akt themelimi hartohet konform ligjit në fuqi në katër kopje për tu dorëzuar në organet kompetente.

**ORTAKET THEMELUES**  
**“AMOSFARMA” SH.P.K**

**Brunilda Hasanbelli**



**Edi Markaj**



**Valbona Kamberi**



# **STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

## **“AMOSFARMA” SH.P.K**

### **NENI 1**

#### **THEMELIMI I SHOQERISË**

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar “AMOSFARMA” SH.P.K , është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i kësaj shoqërie rregullohet me anë të këtij STATUTI dhe me aktin e themelimit të datës 05/04/2023.

Shoqëria vepron në përputhje të plote me Ligjin nr 9901 datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin nr 9723 datë 03.05.2007, Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

### **NENI 2**

#### **EMERTIMI**

Emertimi tregtar i shoqërisë është “AMOSFARMA” SH.P.K

**Inicialet SH.P.K janë te nevojshme te perdoren ne logo ose per qellime promocionale.**

### **NENI 3**

#### **OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë “AMOSFARMA” ShPK është :

1. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm farmaceutike
2. Tregtim me shumice dhe pakice te produkteve nutricional
3. Tregtimi me shumice dhe pakice te produkteve kozmetike dhe estetike

### **NENI 4**

#### **SELIA**

Selia e shoqërisë tregtare me pergjegjesi te kufizuar ndodhet ne adresën, Njesia Administrative Shenkoll, fshati Shenkoll, ndërtesë 2 kateshe, kati i parë e cila është ne pronesi te Z. Angjelin Mark Ndoka. V11. fa 136 me Nr. nasurie 83/207.

Shoqëria ka të drejtë të hapë zyra, përfaqësi dhe filiale edhe në rrethet e tjera të vendit si dhe jashtë shtetit.

## **NENI 5**

### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është e papercaktuar.

Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

## **NENI 6**

### **PERGJEGJËSITË**

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qellime që nuk perputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emërin e tij personal ndaj personave të tretë.

## **NENI 7**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë “AMOSFARMA” SH.P.K, është 1000 (njëmije) lekë, i ndare në 3 kuota me vlerën në përqindje dhe në leke:

- 1- Znj. Brunilda Hasanbelli 51 % të kapitalit ose 1 kuote në vlerë 510 leke**
- 2- Z.Edi Markaj 39 % të kapitalit ose 1 kuote në vlerë 390 leke**
- 3- Znj. Valbona Kamberi 10 % të kapitalit ose 1 kuote në vlerë 100 leke**

## **NENI 8**

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT**

1. Në rastin e transferimit të kuotave të kapitalit ortaku që kërkon të shesë kuotat e tij të kapitalit duhet të njoftojë me shkrim administratorin i cili njofton menjëherë asamblesë së Ortakëve për cmimin e shitjes së kuotave të ortakut që kërkon të shesë.
2. Cmimi i kuotave ofertë për shitje duhet të vëndoset në bazë të vlerës reale të shoqërisë në momentin e dhënies të së drejtës. Ortakët e tjerë mund të blejnë në raport me kutotat ekzistuese duke ruajtur të njëjtat raporte me kuotat që posedon secili prej tyre.

3. Nqs brenda 30 ditëve nga komunikimi i ofertës për shitje të kuotave të kapitalit të shoqërise asnjëri nga ortakët e shoqërisë nuk shprehet për blerjen e tyre atëherë kutotat ofertë shitje mund tu tranferihen cdo personi qe kërkon ti blejë.

## **NENI 9**

### **TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES**

Pjesët e kapitalit janë ligjërisht të tranferueshme mes bashkëshorteve si dhe mes paraardhëseve dhe pasardhëseve. Tranferimi i pjesës së kapitalit mes bashkshortësh në rast ndarje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

## **NENI 10**

### **TRANSFERIMI I PJESËS SË KAPITALIT NË RRUGË TRASËHIMIE OSE FALIMENTIMI**

1. Nëse një ortak vdes trashigimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzoterimit të kutotave dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky përsôn ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesëve të kuotave do të jenë përsôna vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues i të drejtave mbi kuoten e tij, pavarsisht parashikimeve të këtij STATUTI, pasuria e ortakut të vdekur nuk clirohet nga pergjegjësia ne lidhje me kuoten e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me përsôna te tjerë.
2. Përsôni që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratori mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotave ose të kerkoje rregjistrimin e kutotave në emër të një përsôni tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotes. Nëse përsôni i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky përsôn zgjedh që një përsôn tjetër të rregjistrohet si zotërues i kupotes ai kalon kuoten në dobi të përsônit tjetër.
3. Përsôni qe fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të nje ortaku do të ketë të drejtat që gezonte zotëruesi, duke përjashtuar të drejtën e pjesmarrjes ose të votës ne cdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme deri në momentin e rregjistrimit ne QKR.

## NENI 11

### FORMAT E TRANFEERIMIT TË PJESËVE TË KAPITALIT

1. Kontrata për transferimin e pjesës së kapitalit duhet të jetë në formën e aktit noterial dhe në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqërisë, duhet të deklarojë shprehimisht në kontratë se është njohur me aktin e themelimit të shoqërisë dhe STATUTIN e shoqërisë dhe se është dakort me to. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
2. Administratori mund të refuzojë rregjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuote nuk është shlyer plotësisht ose se në rast se administratori nuk është dakort me personelin të cilit i kalon kuota.
3. Nëse administratori apo administratorët refuzojnë ta rregjistrojnë kalimin e kuotes, ata njoftojnë për mospranimin e personit të cilit i kalon kuota. Brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për rregjistrimin e kalimit të kuotes.

## NENI 12

### ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të rrisë pakufi kapitalin e shoqërisë.

Administratorët njoftojnë për rregjistrim pranë QKR vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi mund të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e rregjistrimit të realizimit të tij në QKR.

Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Asambleja e Përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me keto fitime të zmadhojë kapitalin e rregjistruar, të rrisë rezervat statutores ose të shpërndajë dividend.

Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.

Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 përpara se të vendoset për shpërndarje dividendi, administratori lëshon certifikate të aftësisë paguese. Kjo certifikatë lëshohet vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet të mjaftueshme për të shlyer detyrimet bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

## **NENI 13**

### **KRIJIMI I REZERVAVE**

Mbas miratimit të pasqyrave finaciare, asambleja e Përgjithshme krijon rezerva tatutore. Rezerva statutore duhet të jetë për cdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 105 të kapitalit themeltar. Asambleja mund të mos krijojë më rezerva.

## **NENI 14**

### **ZVOGËLIMI I KAPITALI THEMELTAR**

Asambleja e Përgjithshme mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e përcaktuar nga ligji. Reduktimi i kapitalit të shoqërisë përballohet nga secili ortak në mënyre proporcionale sipas kuotave që zotërojnë. Asambleja mund të vendosë reduktimin e kapitalit të shoqërisë brënda limiteve të ligjit qofte edhe nëpërmjet ortakëve të vetëm apo grupe ortakësh, aktivitetësh të shoqërisë apo aksioneve ose kuotave të shoqërisë të tjera në të cilat shoqëria bën pjesë. Vendimi për zvogelimin e kapitalit themeltar i njoftohet QKR për rregjistrim nga administratorët.

## **NENI 15**

### **PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Administratori

## **NENI 16**

### **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PËRGJITHSHME**

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Vendimet e saj me shumicë pengojnë ortakët që mungojnë apo të papajtueshëm përvec rasteve të së drejtës së tyre të kundërshtimit të ushtruar në raste, afate apo forma të parashikuar nga ligji.

Gjatë kohës që shoqëria do të ketë një ortak të vetëm të drejta dhe detyrimet e Asamblese se përgjithshme të ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm rregjistrohen në një rregjistër të vendimëve, të dhënat nuk mund të fshihen apo të ndryshojnë.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërine lidhur me ceshtjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) Ndryshimin e statutit.
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- d) Emërimin, shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) përcaktimin e shpërblimëve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike
- f) Mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedurat e tjera ndaj administratorëve
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- k) Çështje të tjera të parashikuara në ligj

## NENI 17

### MBLEDHJA E ASAMBLEESË DHE VOTIMI

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet të përcaktuara nga ligji nr 9901 datë 14.04.2008 ose nga dispozitat e STATUTIT dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesin e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblese thirret të paktën një herë në vit. Te gjitha vendimet e asamblese së përgjithshme rregjistrohen në proces-verbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të proces-verbalëve të shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret kur nëse sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiarë rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezulton në pasqyrën e fundit financiare të certifikuar.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria brenda dy viteve të para pas rregjistrimit të saj propozon të bliejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 55% të asetëve të shoqërisë që rezulton në pasqyrën e fundit financiare.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni asamblesë së përgjithshme i paraqitet raport nga një ekspert kontabelël i autorizuar.
7. Dispozitat e pikes 6 nuk zbatohen nëse blerjet sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimëve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu këto dispozita nuk zbatohen kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetem.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.
9. Vendimet e ortakëve në mbledhjen e asamblesë ose sipas konsultimit me shkrim merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 3/4 e kapitalit themeltar. Ky numër votash mjafton edhe për ndryshime statutit të shoqërisë.

## **NENI 18**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

1. Ortaku ka të drejtë të informohet lidhur me administrimin e shoqërisë, të njihet me bilancin vjetor dhe të kërkojë me shkrim sqarime të cilat i jep administratori në mbledhjen e asamblesë.
2. Secili nga ortakët ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës tërheqjen nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.
3. Secili ortak që nuk është administrator, ka të drejtë t'i paraqesë dy herë në vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e të cilave vë në dyshim vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë. Lidhur me përgjigjen e administratorit vihet në dijeni edhe eksperti kontabel i autorizuar.
4. Në rast se shoqëria nuk ka ekspert kontabel të autorizuar atëherë emerimi i një eksperti kontabel i autorizuar mund të kërkohet në rrugë gjyqësore nga një ose disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilave përfaqësojnë 5% e kapitali themeltar.
5. Një ose disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilave së bashku përfaqësojnë 5% të kapitalit themeltar, mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një ose disa ekspertëve të ngarkuar për paraqitjen e një raporti për një ose disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorëzohet ortakut/ortakëve që kanë bërë kërkesën, administratorit, eventualisht ekspertëve kontabel të autorizuar në qofte se janë emëruar, raporti paraqitet në mbledhjen e ardhshme të asamblesë.

6. Ortaku nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të miratojë në emër të shoqërisë paradhëniet apo të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pa vlefshëm, kjo vlen edhe përfaqësuesin ligjor të tij, bashkeshortin si dhe paraardhësin dhe pasardhësin e tij.
7. Ortaku person juridik është i detyruar që menjëherën të njoftojë ortakët e tjerë lidhur me ndryshimin e statutit ose të përbërjes së organëve të tij.
8. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
9. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë të përgjithshme.

## **NENI 19**

### **ADMINISTRATORI**

Shoqëria përfaqësohet nga administratori. Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili bashkëngjit emertimin tregtar të shoqërisë, emër mbiemër si dhe funksionin e tij.

## **NENI 20**

### **EMËRIMI I ADMINISTRATORIT**

Administratori i shoqërisë “**AMOSFARMA**” SH.P.K, do të jetë **Z. Edi Markaj**, i cili emërohet nga asambleja e ortakëve me shumicën e votave të ortakëve të kësaj shoqërie.

Administratori **Edi Markaj** emërohet për një afat pesë vjeçar me të drejtë ripërsëritje. Asambleja e përgjithshme mund t'a shkarkojë atë në çdo kohë me shumicën e zakonshme.

## **NENI 21**

### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

1. Administratori ka të drejtë të veprojë në emër të shoqërisë në marrëdhënie me personat e tretë për sa i përket të gjitha çështjeve me përjashtim të atyre që ligji ose ky statut e lë në kompetencë të asamblesë.
2. Administratori ka për detyrë në kuadrin e kompetencave të tij të sigurojë mbajtjen e rregullt të evidences dhe llogarisë sipas ligjit, të mbajë listën e të gjithë ortakëve dhe të informojë ortakët lidhur me çështjet që i takojnë shoqërisë.
3. Administratori ka për detyrë të ngrejë stafin drejtues dhe të pajtojë punëmarres në shoqëri në funksionet që ai i sheh të arsyeshme si dhe nënshkruan kontratat e punës me punëmarresin.

## **NENI 22**

### **DETYRIMET E ADMINISTRATORIT**

1. Administratori i shoqërisë ka detyrë të kryejë funksionin e tij me kujdesin e duhur dhe të ruajë sekretin lidhur me informacionin dhe faktet, transmetimi i të cilave tek personat e tretë mund të shkaktojë dëme për shoqërinë. Detyrimi për të ruajtur sekretin edhe pas mbarimit të funksionit të administratorit.
2. Administratori përgjigjet për dëmin të cilin shkakton nga veprimet e kryera prej tij ne dëm të shoqërisë.
3. Administratori ka detyrë që të pakten një herë në vit ti paraqesë asamblesë raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjendjen e pasurisë së tij.

## **NENI 23**

### **USHTRIMI VJETOR I SHOQËRISË, BILANCI VJETOR, NDARJA E FITIMIT**

1. Viti ushtrimor i aktivitetit të shoqërisë mbyllet me 31 dhjetor. Në fund të vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave të ligjit duke e shoqëruar me një relacion shtesë për aktivitetin e shoqërisë.
2. Cdo ortak ka të drejtë të ketë nga administratori lajme për zhvillimin e punëve të shoqërisë dhe të konsultohet me librat e shoqërisë.

## **NENI 24**

### **NDARJA E FITIMIT**

Pas plotësimit të parashikimeve të nënit 77 të ligjit 9901 datë 18.04.2008, shoqëria me shumice të kualifikuar votave të asamblesë së përgjithshme ose të ortakut të vëtëm mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat perkatëse të ortakëve.

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor i reduktuar me 5% të destinuar për rezerve ligjore që arrijnë deri në 10% të kapitalit të shoqërisë, si dhe reduktimeve eventuale të përcaktuara nga asambleja, shpërndahen ndërmjet ortakëve në raport me kuotat e kapitalit që zotëron secili.

## **NENI 25**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrveshjet qe mund të lindin gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë nga interpretimi, zbatimi i Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë si dhe të gjitha mosmarrveshjet mes ortakëve apo midis një ortaku dhe shoqërisë në parim do të zgjidhen me mirëkuptim në bazë të aktit të themelimit dhe statutit. Në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim zgjidhja i besohet gjykatës shqiptare kompetente.

## **NENI 26**

### **SHKRIRJA E SHOQËRISË**

Shoqëria shkrihet :

1. Ditën e shënuar në vendimin e asamblesë për shkrirjen e shoqërisë.
2. Ditën e shënuar në rregjistrin tregtar të QKR për shkrirjen e shoqërisë.
3. Në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

## **NENI 27**

### **GJUHA**

Ky statut është redaktuar në Lezhë sot me date 05/04/2023 në katër kopje origjinale dhe në gjuhën shqipe.

## **NENI 28**

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

Përsa nuk është shprehur ne këtë statut është kompetence e asamblesë së përgjithshme së ortakëve ose ortakut të vetëm nëse shoqëria është ortak i vetëm, qe të bëjë plotësimin e dispozitave të këtij statuti si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave të cilat bëhen të pavleshme dhe jo efektive dhe këto ndryshime do të bëhen në formën e një dokumenti noterial.

**Ortakët themelues**

**“AMOSFARMA” SH.P.K**

**Brunilda Hasanbelli**

**Edi Markaj**

**Valbona Kamberi**